

**ENTI RREGULLATOR I UJIT**



## **RAPORT**

# **BILANCI I UJIT I SHOQËRIVE UK (VITI 2021)**

**Shtator, 2022**

## PËRMBAJTJA

<b>1</b>	<b>Metodologjia e Hartimit të Bilancit të Ujit</b> .....	<b>5</b>
<b>1.1</b>	<b>Bilanci i Ujit, Komponentët Përbërës të Tij</b> .....	<b>6</b>
1.1	Volumi i Ujit që Hyn në Sistem.....	6
1.2	Konsumi i Autorizuar i Matur dhe i Pamatur .....	10
1.3	Uji Pa të Ardhura, Humbjet e Dukshme dhe Humbjet Reale .....	14
	<b>Benchmarking i Bilancit të Ujit për vitin 2021, Trendi dhe Krahasimi me Vitin 2020</b> .....	<b>28</b>
	<b>Benchmarking i Balanceve të Ujit 2020 - 2021 për Sektorin</b> .....	<b>32</b>

## LISTA E TABELAVE

<b>Tabela 1</b>	Bilanci i Ujit sipas IWA-s.....	<b>5</b>
<b>Tabela 2.</b>	Uji i Prodhuar dhe Niveli Matjes - Grupi i I-rë.....	<b>6</b>
<b>Tabela 3</b>	Uji i Prodhuar dhe Niveli Matjes - Grupi i II-të.....	<b>7</b>
<b>Tabela 4</b>	Uji i Prodhuar dhe Niveli Matjes - Grupi i III-të.....	<b>9</b>
<b>Tabela 5</b>	Uji i Prodhuar dhe Niveli Matjes për Sektorin e Ujit.....	<b>9</b>
<b>Tabela 6</b>	Konsumin i Autorizuar i Ujit, i Matur dhe i Pamatur Grupi i I-rë .....	<b>11</b>
<b>Tabela 7</b>	Konsumin i Autorizuar i Ujit, i Matur dhe i Pamatur Grupi i II-të .....	<b>12</b>
<b>Tabela 8</b>	Konsumin i Autorizuar, i Matur dhe i Pamatur Grupi i III-të.....	<b>13</b>
<b>Tabela 9</b>	Konsumi i Autorizuar i Matur dhe i Pamatur për Sektorin .....	<b>13</b>
<b>Tabela 10</b>	UPA, Humbjet e Dukshme, Reale dhe nga Konsumi i Pa autorizuar- Grupi i I-rë .....	<b>18</b>
<b>Tabela 11</b>	Konsumi i Faturuar Mesatar Ditor për Konsumatorët Familjarë me Matje dhe Aforfe Grupi i I-rë.....	<b>19</b>
<b>Tabela 12</b>	UPA, Humbjet e Dukshme, Reale dhe nga Konsumi i Pa autorizuar- Grupi i II-të .....	<b>22</b>
<b>Tabela 13</b>	Konsumi i Faturuar Mesatar Ditor për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe Grupi i II-të .....	<b>23</b>
<b>Tabela 14</b>	UPA, Humbjet e Dukshme, Reale dhe nga Konsumi i Pa Autorizuar- Grupi i III-të .....	<b>25</b>
<b>Tabela 15-</b>	Konsumi i Faturuar Mesatar Ditor për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe Grupi i III-të .....	<b>25</b>
<b>Tabela 16</b>	UPA, Humbjet e Dukshme, Reale dhe nga Konsumi i Paautorizuar - në Total .....	<b>26</b>
<b>Tabela 17</b>	Bilanci i Ujit për Sektorin për Vitin 2021 sipas IWA-s .....	<b>27</b>
<b>Tabela 18</b>	Bilanci i Ujit për Vitin 2021 sipas formatit të miratuar nga ERRU.....	<b>28</b>
<b>Tabela 19</b>	Krahasimi dhe Trendi i Komponentëve të Bilancit të Ujit - Grupi I-rë .....	<b>29</b>
<b>Tabela 20</b>	Krahasimi dhe Trendi i Komponentëve të Bilancit të Ujit- Grupi II-të .....	<b>30</b>
<b>Tabela 21</b>	Krahasimi dhe trendi i komponentëve të bilancit të ujit - Grupi III-të.....	<b>31</b>
<b>Tabela 22</b>	Krahasimi dhe Trendi i Komponentëve të Bilancit të Ujit në Total për Sektorin .....	<b>32</b>

## Të Përgjithshme

Gjatë operimit të sistemeve të furnizimit me ujë, humbjet e ujit janë një pengesë e madhe për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërive UK pasi ato kanë ndikim të drejtpërdrejtë në burimet ujore, në kostot operative, eficientë e energjisë, cilësinë e shërbimit të konsumatorëve etj.

Sasia e ujit që humbet, për të cilat shoqëritë UK nuk arrijnë të mbledhin të ardhura, konsiderohet Ujë Pa të Ardhura (UPA). UPA përbëhet nga tre komponentë bazë: Humbjet e Dukshme (administrative), Humbjet Reale (fizike) dhe Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar.

Procesi i reduktimit të UPA-së në çdo shoqëri ujësjellësi është i suksesshëm nëse përkushtimi ndaj tij është në shkallën e duhur. Hartimi i planeve të veprimit për reduktimin e humbjeve të ujit duhet të jetë pjesë përbërëse e pashmangshme e politikës së menaxhimit të një shoqërie ujësjellësi.

Për t'ju ardhur në ndihmë shoqërive UK, ERRU me vendimin nr.46, datë 27.12.2013 të Komisionit Kombëtar Rregullator, ju kërkon shoqërive të dorëzojnë pranë saj formatin e "Bilancit të Ujit" për periudhën e 6-të mujorit të parë dhe të dytë të vitit ushtrimor përkatës.

Ky format bazohet në bilancin e ujit, i hartuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Ujit (IWA), i cili është dhe formati më i mirë ndërkombëtar për identifikimin, matjen dhe analizimin e humbjeve të ujit. Format i mbi humbjet e ujit ndihmon shoqëritë e ujësjellësit të kuptojnë origjinën dhe natyrën e humbjeve të ujit të cilat do të jenë dhe përcaktuese për hartimin e planeve për reduktimin e tyre. Në këtë format, çdo shoqëri UK paraqet të dhëna mbi variabëlën "Sasia e ujit që hyn në sistemin e furnizimit", "Konsumin e Autorizuar", Humbjet Administrative (të dukshme)" si dhe Humbjet Reale (fizike).

Serioziteti gjatë hartimit të Bilancit të Ujit, vlerësimi i komponentëve përbërës të tij, bazuar në matje apo vlerësime sa më pranë vlerave reale, është përcaktues në saktësinë e nivelit të Ujit Pa të Ardhura të çdo shoqërie UK.

Niveli i lartë i Ujit Pa të Ardhura në sektorin UK si dhe ritmi i ngadaltë i përmirësimit të tij mbetet shqetësimi kryesor i ERRU-së. Për t'u bërë të njohur me situatën mbi nivelin e UPA në sektor si dhe të çdo shoqërie UK më vete, ERRU përgatit raportin vjetor "**Bilanci i ujit për shoqëritë UK**" i cili bazohet në të dhënat vjetore të raportuara pranë sektorit teknik nga të gjitha shoqëritë UK që operojnë në vendin tonë.

Gjatë procesit të dorëzimit të bilancit të ujit, ERRU ndihmon shoqëritë dhe orienton ato në punën e tyre, si të analizojnë dhe monitorojnë të gjitha nën-komponentët e humbjeve të ujit që përbëjnë këtë bilanc.

Në bilancet e dorëzuara pranë ERRU-së për vitin 2021, vështirësitë gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të formatit u hasën në shumë shoqëri UK, sidomos ato të grupit të dytë dhe të tretë. Nevoja për trajnimin profesional të stafeve teknike mbi "menaxhimin e humbjeve të ujit" u vërejt pothuaj në shumicën e shoqërive, ndonëse ky është i nënti vit që bilancet hartohen prej tyre.

Për vitin 2021, nuk kanë raportuar të dhënat e kërkuara mbi Bilancet e Ujit shoqëritë UK Selenicë, UK Pustec, UK Poliçan, UK Peqin dhe UK Divjakë. Të dhënat e paraqitura për këto shoqëri janë marrë nga raportimi i tyre pranë njësisë së Monitorimit të ERRU-së, dhe jo si bilanc më vete.

**Për vitin 2021, "Sasia e ujit të prodhuar" nga të gjitha shoqëritë UK është 311,058,845 m<sup>3</sup>. Prodhimi total matet në nivelin 59.6%, ndërsa pjesa e mbetur vlerësohet.**

Mungesa e matësave në pikat e prodhimit dhe për pasojë niveli i ulët i matjes për ujin e prodhuar, mbeten emergjente. Gabimi gjatë vlerësimit të sasive të prodhuara në nivelin 3.93% e sasisë së ujit të prodhuar, bën që dhe niveli i UPA t'i largohet nivelit real të tij. Mungesa e matësave në pikat kyçe të prodhimit dhe vlerësimi i gabuar i tij, shpesh herë shoqërohet me luhatje të pa arsyetuar të nivelit të UPA për disa shoqëri UK, nga një vit në tjetrin.

*Gjatë vendosjes së objektivave në procesin tarifor që ERRU vendos për të gjitha shoqëritë UK, në planin kryesor mbetet instalimi i ujëmatësve në prodhim dhe për të gjithë kategoritë e konsumatorëve.*

Faturimi Total në nivelin **35.59%**, paraqiti trend në përmirësim, Faturimi i Matur është 75.6% e faturimit total, pjesa tjetër faturohet aforfe. Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar (1,084,054 m<sup>3</sup>) edhe gjatë këtij viti paraqiti tendencë në përmirësim. Nga bilancet e dorëzuara u vu re se disa shoqëri raportojnë këtë konsum në nivele të pa justifikueshme, sasi të mëdha raportohen në larjet e depove dhe shuarjen e zjarreve ndonëse depot në përdorim apo numri i zjarreve të rëna kanë nevojë për volume më të vogla për finalizimin e këtyre proceseve. Gjithashtu u konstatua se uji i falur nga shumë shoqëri UK nuk i'u falet konsumatorëve me vendim të Këshillit të Administrimit të shoqërisë përkatëse.

Bazuar në të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara, **niveli i "Ujit Pa të Ardhura", i përmirësuar me (-1.03%), aktualisht është 64.41%.**

**Humbjet administrative** përbëjnë mesatarisht 48% të humbjeve të përgjithshme ndërsa **Humbjet Reale** 52% e tyre. Bazuar në nivelin e humbjeve, domosdoshmëria e menaxhimit më të mirë të shoqërive mbetet ende imediate.

**Humbjet e përgjithshme**, të përbëra nga Humbjet e Dukshme (administrative) dhe Humbjet Reale (fizike), janë 199,273,028 m<sup>3</sup> ose 64.06% e ujit të prodhuar.

Nga krahasimi i bërë me të dhënat e vitit të kaluar, sasi të ujit që humbasin si pasojë e lidhjeve të paligjshme në transmetim dhe shpërndarje së bashku, rezultuan me trend në përkeqësim me (+1.02%).

Nën komponentë të humbjeve administrative janë edhe humbjet e shkaktuara nga pasaktësitë në matje në prodhim e në konsumator, të cilat për këtë vit përbëjnë 10.2% të ujit të prodhuar ose 31,671,621 m<sup>3</sup>. Kërkohej vëmendje dhe angazhim më i madh i shoqërive për zvogëlimin dhe eliminimin e tyre si dhe pajisjen me ujëmatës sa më parë të të gjithë klientëve, si dhe në pikat kyçe të sistemit të furnizimit.

Detaje të problematikave mbi Bilancin e Ujit, nivelin e humbjeve të nën komponentëve përbërës të tij për gjatë vitit 2021, pasqyrohen në analizën e mëposhtme. Gjatë analizës shoqëritë janë ndarë në tre grupe, bazuar kjo në numrin e lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë.

## 1 Metodologjia e Hartimit të Bilancit të Ujit.

Bilanci i Ujit hartohet duke respektuar formatin e Shoqatës Ndërkombëtare të Ujësjesve (IWA). Qëllimi kryesor në respektimin e këtij formati është unifikimi i metodologjisë dhe terminologjisë për të gjithë shoqëritë UK duke i vendosur ato në të njëjtat kushte vlerësimi për secilin nga komponentët e bilancit të ujit.

Metodika e hartimit të bilancit të përdorur nga të gjitha shoqëritë në vendin tonë është ajo “lart-poshtë” (top-down), e cila fillon llogaritjet e të gjithë komponentëve të saj nga sipër, pra nga Konsumi i Autorizuar i ujit dhe më tej vazhdon me llogaritjen e Humbjeve të Dukshme ose Humbjeve Administrative. Me deduksion më tej përcaktohen Humbjet Reale ose Humbjet Fizike.

Këto janë edhe arsyet kryesore që aktualisht për hartimin e bilancit të ujit nga shoqëritë UK nuk mund të përdoret metoda nga “poshtë lart” (down-top) që përdoret gjerësisht nga shoqëritë e ujësjesve të përparuara që kanë rrjete inxhinierike me matje, si dhe disponojnë teknologjinë e duhur të monitorimit dhe kontrollit që përdoret për përcaktimin e humbjeve.

Në Tabelën 1, paraqiten komponentët përbërëse të Bilancit të Ujit të cilat llogariten duke u bazuar në të dhënat e grupuara vjetore nga çdo shoqëri UK.

**Tabela 1 Bilanci i Ujit sipas IWA-s**

Uji Prodhuar nga Burimet e Veta	Volumi i Ujit që Hyn në Sistem	Konsumi i Autorizuar	Konsumi i Autorizuar, i Faturuar	Uji i eksportuar		Uji me të Ardhura		
				Konsum i matur	Konsum i pamatur			
Uji	Eksportuar (i blerë)	Humbjet e Ujit	Konsum i Autorizuar, i Pafaturuar	Konsum i matur	Konsum i pamatur	Uji Pa të Ardhura		
			Humbjet Administrative	Konsum i pamatur	Konsum i paautorizuar			
				Pasaktësia në ujëmatëse	Gabime sistematike në trajtimin e të dhënave			
				Rrjedhjet në tubacionet e transmetimit dhe shpërndarjes	Rrjedhjet dhe derdhjet në depot e Shoqërive			
			Humbjet Teknike		Rrjedhjet në lidhjet e shërbimit të konsumatorëve deri në pikën e matjes			

## 1. Bilanci i Ujit, Komponentët Përbërës të Tij

### 1.1 Volumi i Ujit që Hyn në Sistem

***Volumi i ujit që hyn në sistemin e furnizimit konsiderohet sasia e ujit të prodhuar në një vit kalendarik plus sasinë e ujit të blerë me shumicë nga operatorët e tjerë.***

Duke ditur se, matja apo vlerësimi i saktë i volumit të prodhuar është faktori kryesor përcaktues në nivelin real të treguesit UPA, ERRU udhëzon shoqëritë UK se në mungesë të matësve në burim, kaptazhe, puse, veprat e marrjes nga basenet sipërfaqësorë, si dhe në dalje të stacioneve qendrore të pompimit, të zbatojnë siç duhet procedurat e vlerësimit të volumeve duke u bazuar në rekomandimet teknike.

Disa operatorë ende nuk zbatojnë siç duhet procedurat e vlerësimit të volumeve sipas rekomandimeve përkatëse teknike. Mungesa e informacionit mbi kapacitetet max dhe min të burimeve ujore, mungesa e regjistrave në depo dhe stacione pompimi ku të regjistrohen sasinë ditore të prodhuara, janë faktorë të cilët influencojnë në nivelin real të Ujit Pa të Ardhura, sidomos në shoqëritë e Grupit të II-të dhe të III-të.

**Grupi i I-rë** (me më shumë se 15,000 lidhje uji)

Për vitin 2021, të gjitha shoqëritë e Grupit të I-rë së bashku kanë prodhuar **255,254,680 m<sup>3</sup> ujë**.

Niveli i matjes për ujin e prodhuar është përmirësuar me rreth 4.8%. ***Aktualisht, në këtë grup “uji i prodhuar” rezulton i matur vetëm për 68% të prodhimit total ku vetëm 5 shoqëri UK matin 100% të sasisë së ujit të prodhuar përkatësisht UK Durrës, Vlorë, Korçë, Kavajë, Sarandë.***

Krahasuar me vitin 2020, mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë u përmirësua me **1.57 %** ndërsa prodhimi total në grup u rrit me rreth 2 milion m<sup>3</sup>.

Tabela 2 jep prodhimin e ujit dhe nivelin e matjes së tij për Grupin e I-rë në zonën e shërbimit.

**Tabela 2. Uji i Prodhuar dhe Niveli Matjes - Grupi i I-rë**

Nr.	Operatorët UK	Popullsia në zonën e shërbimit	Popullsia me shërbim	Ujë i Prodhuar (m <sup>3</sup> )	Ujë i Prodhuar	Volumi i matur	Uji i Prodhuar i Matur
					(litra/dite, banor)	(m <sup>3</sup> )	(%)
1	Tiranë	851,728	826,452	92,927,064	308	67,540,214	73%
2	Durrës	360,592	345,265	44,386,103	352	44,386,103	100%
3	Vlorë	200,574	183,393	22,915,717	342	22,915,717	100%
4	Elbasan	218,780	155,454	17,498,000	308	0	0%
5	Fier	197,200	124,600	18,674,000	411	5,602,200	30%
6	Shkodër	208,618	118,043	12,744,952	296	0	0%
7	Korçë	130,114	120,000	3,511,380	80	3,511,380	100%
8	Berat Kuçovë	155,004	109,499	8,313,480	208	883,548	11%
9	Kavajë	84,250	82,443	8,458,890	281	8,458,890	100%
10	Kamëz	138,515	101,016	9,947,418	270	6,894,647	69%
11	Lushnje	127,438	93,536	5,984,581	175	5,568,581	93%
12	Sarandë	58,300	58,400	4,301,000	202	4,301,000	100%
13	Pogradec	91,797	78,527	2,460,195	86	2,185,695	89%
14	Lezhë	91,091	67,978	3,131,900	126	2,192,330	70%
Totali		<b>2,914,001</b>	<b>2,464,606</b>	<b>255,254,680</b>	<b>284</b>	<b>174,440,305</b>	<b>68%</b>

## Nga Tabela e mësipërme konstatohet:

- Mbulimi me shërbim arrin të kryhet për **84.57%** e popullsisë së zonës së juridiksionit.
- Shoqëritë e Grupi i I-rë së bashku, ofrojnë shërbim për 77% të lidhjeve me ujin në sektor. Niveli i matjes për ujin e prodhuar (68%) paraqet trend në përmirësim. Në përgjithësi, prodhimi (l/ditë, banor) është i mjaftueshëm për furnizimin normal me ujë të konsumatorëve. Shoqëritë me rrëgjim të kufizuar të furnizimit shpesh herë kanë normë prodhimi (l/ditë, banor) më të lartë se ato me rrëgjim 24/7. ERRU rekomandon përmirësimin e menaxhimit të shoqërive UK, të gërshetuar me investime fizike në sistemet e furnizimit.
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit, lidhur me kohëzgjatjen e furnizimit me ujë 24/7 në këto shoqëri, nuk duhet të bazohet në rritjen e volumit të prodhuar, por me reduktimin e humbjeve totale.
- Mungesa e matësve në prodhim dhe mos zëvendësimi i tyre në rast defektesh vërehet pothuajse në shumë shoqëri të grupit të parë.

## Grupi i II-të (me 3,000 deri 15,000 lidhje uji)

Bazuar në raportimet e bëra, shoqëritë e Grupit të II-të prodhuan **49,878,743 m<sup>3</sup>** ujë. Me nivel të matjes 100% për ujin e prodhuar u paraqitën katër shoqëri UK, 19 prej tyre nuk kanë të instaluar asnjë aparat ujëmatës, dhe pjesa e mbetur paraqitet me nivele të ulëta të matjes. **Aktualisht shoqëritë e Grupit të II-të arrijnë të matin vetëm 19% të prodhimit.**

Trendi në përmirësim për faktorin “ujë i prodhuar” nuk reflektohet në treguesin “niveli i matjes”. Shoqëritë duhet të bëjnë vlerësimin e nevojave për investime në ujëmatës dhe të bëjnë përpjekje për të matur prodhim në çdo pikë ku ai përftohet.

Tabela 3 jep prodhimin e ujit dhe nivelin e matjes së tij për Grupin e II-të në zonën e shërbimit.

**Tabela 3 Uji i Prodhuar dhe Niveli Matjes - Grupi i II-të**

Nr.	Operatorët UK	Popullsia në zonën e shërbimit	Popullsia me shërbim	Ujë i Prodhuar (m <sup>3</sup> )	Ujë i Prodhuar	Volumi i matur	Uji i Prodhuar i Matur
					(litra/ditë, banor)	(m <sup>3</sup> )	(%)
1	Maliq	62,000	42,010	1,170,716	76	661,347	56%
2	Gjirokastrë	51,875	51,875	2,479,608	131	0	0%
3	Devoll	41,493	39,320	1,482,531	103	1,042,127	70%
4	Dibër	78,000	31,000	2,612,440	231	0	0%
5	Cërrik	48,166	30,604	2,393,629	214	93,629	4%
6	Belsh	32,639	23,526	1,384,841	161	0	0%
7	Kurbini	66,458	30,686	2,104,228	188	30,587	1%
8	Kukës	47,963	29,116	2,749,939	259	0	0%
9	Librazhd	77,223	22,345	1,350,000	166	0	0%
10	Divjakë	55,260	30,390	2,035,000	183	190,000	9%
11	Mat	37,846	31,688	1,769,000	153	0	0%

12	Himarë	25,688	23,399	1,119,900	131	0	0%
13	Krujë	80,807	35,140	2,210,644	172	2,210,644	100%
14	Mallakastër	40,292	31,283	1,600,000	140	1,100,000	69%
15	Patos	43,715	31,897	2,701,000	232	0	0%
16	Malësi e Madhe	54,156	30,783	1,267,100	113	0	0%
17	Gramsh	25,300	22,728	1,180,000	142	0	0%
18	Rrogozhinë	42,666	28,139	931,000	91	931,000	100%
19	Bulqizë	42,386	21,635	1,773,000	225	0	0%
20	Përmet	19,872	19,022	764,500	110	0	0%
21	Dropull	22,278	22,278	1,266,000	156	0	0%
22	Vorë	39,592	21,922	2,020,200	252	103,200	5%
23	Kolonjë	15,150	15,150	390,000	71	390,000	100%
24	Ura Vajguore	40,094	20,504	1,172,222	157	0	0%
25	Selenicë	18,465	13,736	2,825,000	563	0	0%
26	Peqin	39,260	18,666	1,750,000	257	1,130,000	65%
27	Skrapar	16,250	15,110	796,000	144	0	0%
28	Tropojë	28,010	16,407	870,000	145	459,000	53%
29	Vau Dejës	51,724	29,593	975,500	90	975,500	100%
30	Delvinë	18,837	16,783	492,900	80	0	0%
31	Roskovec	32,670	16,452	947,845	158	0	0%
32	Mirditë	37,499	20,828	831,000	109	0	0%
33	Poličan	17,271	11,864	463,000	107	183,000	40%
	<b>Totali</b>	<b>1,350,905</b>	<b>845,879</b>	<b>49,878,743</b>	<b>161.6</b>	<b>9,500,034</b>	<b>19%</b>

#### Nga Tabela e mësipërme konstatohet që:

- *Mbulimi me shërbim kryhet për 63% të popullsisë në juridiksion.*
- *Shumica e shoqërive disponojnë kapacitete të mjaftueshme për furnizimin pa ndërprerje të popullsisë. Nevojitet reduktimi i UPA, investime të reja si dhe menaxhim më i mirë nga stafet drejtuese e teknike të shoqërive.*
- *Sasia e ujit të prodhuar (litra/ditë, banor) në rang grupi, është e mjaftueshme për një furnizim normal me ujë të konsumatorëve. Me normë të ulët të prodhimit (litra/ditë, banor) paraqitet UK Kolonjë ( 71 litra/ditë, banor) ndonëse raporton prodhim të matur 100% dhe kohëzgjatje të furnizimit me ujë për 21 orë/ditë. Rekomandohet që të kryhet analizë e kujdesshme ku të saktësohen të dhënat në lidhje me nivelin e matjes dhe sasinë e ujit të prodhuar pasi raportimet nuk janë të njëjta me ato të raportuara në Njësinë e Monitorimit pranë ERRU-së (raportohet prodhim i matur dhe i vlerësuar).*

#### Grupi i III-të (me më pak se 3,000 lidhje uji)

**Shoqëritë e Grupit të III-të** kanë prodhuar **5,925,422 m<sup>3</sup>** ose 28% më shumë se një vit më parë, pasi këtij grupi ju bashkëngjiten dhe shoqëritë UK Finiq dhe Tepelenë. Niveli i matjes për faktorin “Ujë i prodhuar” vazhdon të jetë në nivelin 23%, vetëm UK Fushë Arrëz raporton të matur 100% prodhimin vjetor. Krahasimi i të dhënave në vite tregoi se niveli i matjes për ujin e prodhuar për disa shoqëri ka luhatur më shumë si rezultat i raportimeve të papërgjegjshme dhe mos zëvendësim të ujëmatësve në rast të dëmtimit të tyre.



Tabela 4 jep prodhimin e ujit dhe nivelin e matjes së tij për grupin e III-të në zonën e shërbimit.

**Tabela 4 Uji i Prodhuar dhe Niveli Matjes - Grupi i III-të**

Nr.	Operatorët UK	Popullsia në zonën e shërbimit	Popullsia me shërbim	Ujë i Prodhuar (m <sup>3</sup> )	Ujë i Prodhuar	Volumi i matur	Uji i Prodhuar i Matur
					(litra/ditë, banor)	(m <sup>3</sup> )	(%)
1	Tepelenë	15,704	12,222	465,000	104	153,000	33%
2	Finiq	35,216	15,636	1,031,100	181	119,100	12%
3	Konispol	13,705	13,005	410,672	87	0	0%
4	Memaliaj	19,866	10,219	226,350	61	0	0%
5	Klos	20,578	7,061	439,000	170	131,550	30%
6	Pukë	15,628	6,165	263,000	117	100,100	38%
7	Këlcyrë	12,389	5,788	856,000	405	0	0%
8	Has	13,448	9,326	797,900	234	685,800	86%
9	Libohovë	7,200	7,200	1,148,400	437	0	0%
10	Fushë Arrëz	11,000	4,800	192,000	110	192,000	100%
11	Pustec	5,182	2,682	96,000	98	0	0%
<b>Totali</b>		<b>169,916</b>	<b>94,104</b>	<b>5,925,422</b>	<b>173</b>	<b>1,381,550</b>	<b>23%</b>

Nga Tabela e mësipërme konstatohet që:

- *Mbulimi me shërbim arrin të kryhet për 55.4% të popullsisë në juridiksion.*
- *Përgjithësisht sasia e ujit e prodhuar (litra/ditë, banor) është e mjaftueshme për një furnizim normal me ujë të konsumatorëve, përveç UK Memaliaj për të cilën rekomandohet të bëjë kujdes gjatë vlerësimit të variabëlilit “uji i prodhuar” pasi raporton se prodhon 61 litra/ditë, banor ndërkohë që ofron shërbimin e furnizimit me ujë përafërsisht 17.5 orë/ ditë.*
- *Mungesa e matësive në prodhim, pamundësitë financiare për instalimin apo zëvendësimin e tyre në rast defektesh mbetet faktor në luhatjen dhe nivelin e ulët të matjes për ujin e prodhuar i cili edhe për këtë vit është 23%.*

Në mënyrë të përmbledhur gjendja e sektorit në lidhje me volumin e ujit të prodhuar dhe nivelin e matur të tij jepet në Tabela 5.

**Tabela 5 Uji i Prodhuar dhe Niveli Matjes për Sektorin e Ujit**

Grupet UK	Popullsia në zonën e shërbimit	Popullsia me shërbim	Ujë i Prodhuar (m <sup>3</sup> )	Ujë i Prodhuar	Volumi i matur	Uji i Prodhuar i Matur
				(litra/ditë, banor)	(m <sup>3</sup> )	(%)
Grupi I- rë	2,914,001	2,464,606	255,254,680	284	174,440,305	68%
Grupi II-të	1,350,905	845,879	49,878,743	162	9,500,034	19%
Grupi III-të	169,916	94,104	5,925,422	173	1,381,550	23%
<b>Totali</b>	<b>4,434,822</b>	<b>3,404,589</b>	<b>311,058,845</b>	<b>250</b>	<b>185,321,889</b>	<b>60%</b>

Të dhënat në tabelën e mësipërme tregojnë se gjatë vitit 2021,

- “Mbulimi me ujë” në sektor realizohet për **76.8%** të popullsisë në juridiksion.
- Shoqëritë UK kanë prodhuar **311,058,845 m<sup>3</sup>** ujë, nga të cilat 60% raportohet i matur dhe 40% i vlerësuar.
- Prodhimi i ujit litra/ditë, për banor përgjithësisht është i mjaftueshëm për furnizimin me ujë 24/7 të banorëve, emergjente mbetet reduktimi i Ujit Pa të Ardhura dhe pajisja e burimeve të shfrytëzueshme me ujëmatës.

### **Si konkluzion**

- Volumet e raportuara mbi faktorin “Ujë i prodhuar” duhen marrë me rezervë, mungesa e ujëmatësve në çdo pikë të shfrytëzueshme për shërbimin e furnizimit me ujë ende mbetet një problem me ndikim të madh në nivelin e UPA në sektor.
- Niveli i matjes për ujin e prodhuar nga shoqëritë e Grupit të II-të e të III-të paraqitet në nivele jo të kënaqshme. Nga 58 shoqëri UK, 26 prej tyre nuk kanë asnjë ujëmatës në burim. Për shoqëritë e Grupit të I-rë, mungesa e matësve në prodhim është e pa tolerueshme. Me nivel të ulët të matjes u paraqiten UK Elbasan, UK Shkodër, UK Fier, UK Berat-Kuçovë.
- Monitorimi i vlerësimit të prurjeve në ato sisteme që nuk kanë matës në burim duhet të jetë prioritet i shoqërive UK në mënyrë që të kemi një bazë vlerësimi të treguesit të Ujit Pa të Ardhura sa më afër realitetit.
- Sasia e ujit e prodhuar, për disa nga shoqëritë është e pamjaftueshme për furnizimin e popullatës. Për rritjen e cilësisë së shërbimeve, me synimin e furnizimit me ujë pa ndërprerje (24/7), kërkohet rritja e sasisë së ujit të prodhuar dhe ndoshta gjetja e burimeve të reja.

### **1.2 Konsumi i Autorizuar i Matur dhe i Pamatur**

**Konsumi i autorizuar** është volumi i ujit të matur dhe të pamatur që merret nga konsumatorët për përdorim vetjak, komerciale, industriale me bazë kontrate që ky konsumator ka me shoqërinë UK.

#### **Grupi i I-rë**

**Konsumi i Autorizuar Total** nga shoqëritë e Grupit të I-rë raportohet **85,395,547 m<sup>3</sup>** ose 4% me shumë se viti i kaluar.

**Konsumi i Autorizuar i Faturuar** matet në nivelin 79% të konsumit total. Gjatë analizës vërehet se investime për rritjen e numrit të lidhjeve me matës kanë kryer pothuaj të gjitha shoqëritë e grupit. Për vitin 2021, me nivelin më të ulët të matjes paraqitet UK Vlorë (53%).

**Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar** (nevoja vetjake të shoqërisë, larje deposh, zjarrfikës etj) përbën 1% të Konsumit Total të Autorizuar. Gjatë analizës së bilanceve të dorëzuara vërehet se disa prej shoqërive raportojnë nivele të këtij konsumi mbi nevojat vetjake.

Konsumin e Autorizuar të Matur dhe të Pamatur të ujit për Grupin e I-rë jepen në Tabelën 6.

**Tabela 6 Konsumin i Autorizuar i Ujit, i Matur dhe i Pamatur Grupi i I-rë**

Nr.	Operatorët UK	Konsumi i Autorizuar i Faturuar			Uji i Faturuar me Matje në %	Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar			Uji i Pa Faturuar me matje në %
		Total (m3)	I matur (m <sup>3</sup> )	Aforfe (m3)		Totali	I matur (m <sup>3</sup> )	I vlerësuar (m <sup>3</sup> )	
1	Tirane	38,377,761	31,402,583	6,975,178	82%	17,897	0	17,897	0%
2	Durrës	9,214,268	8,446,288	767,980	92%	0	0	0	0%
3	Vlorë	5,462,000	2,887,000	2,575,000	53%	54,000	0	54,000	0%
4	Elbasan	4,466,630	3,309,607	1,157,023	74%	175,540	0	175,540	0%
5	Fier	4,654,000	2,836,000	1,818,000	61%	30,000	0	30,000	0%
6	Shkodër	3,921,535	2,281,173	1,640,362	58%	106,913	0	106,913	0%
7	Korçë	2,293,742	2,293,742	0	100%	530	0	530	0%
8	Berat Kuçovë	2,836,183	2,027,183	809,000	71%	74,826	0	74,826	0%
9	Kavajë	2,828,000	2,010,000	818,000	71%	56,000	0	56,000	0%
10	Lushnje	2,911,000	2,308,000	603,000	79%	96,940	620	96,320	1%
11	Kamëz	1,976,909	1,915,705	61,204	97%	35,000	0	35,000	0%
12	Sarandë	2,223,327	2,174,058	49,269	98%	93,010	0	93,010	0%
13	Lezhë	1,507,236	1,401,279	105,957	93%	22,200	0	22,200	0%
14	Pogradec	1,955,640	1,512,495	443,145	77%	4,460	0	4,460	0%
<b>Totali</b>		<b>84,628,231</b>	<b>66,805,113</b>	<b>17,823,118</b>	<b>79%</b>	<b>767,316</b>	<b>620</b>	<b>766,696</b>	<b>0%</b>
<b>Konsumi i Autorizuar në Total 85,395,547 m<sup>3</sup></b>									

### Grupi i II-të

Për Grupin e II-të të shoqërive, **Konsumi i Autorizuar total** rezultoi 3% me pak se viti i kaluar ose **23,854,225 m<sup>3</sup>**. **Konsumi i Autorizuar i Matur në nivelin 65%**, paraqiti tendencë në përmirësim për vitin 2021, me nivel të matjes 100% të konsumit të autorizuar u paraqiten shoqëritë UK Belsh dhe Devoll. **Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar** është i vlerësuar tërësisht, në rang grupi ky konsum përbën 1% të konsumit total të autorizuar dhe shpesh here raportohet mbi nivelet e arsyetuara për qëllimet e përdorura.

Detaje për Konsumin e Autorizuar të Matur dhe të Pamatur për grupin e II-të jepen në Tabelën 7.

**Tabela 7 Konsumin i Autorizuar i Ujit, i Matur dhe i Pamatur Grupi i II-të**

Nr .	Operatorët UK	Konsumi i Autorizuar i Faturuar			Uji i Faturuar me Matje ne %	Konsumi i Autorizuar i Pafaturuar			Uji i Pafaturuar me matje ne %
		Total (m3)	I matur (m³)	Aforfe (m3)		Totali	I matur (m³)	I vlerësuar	
1	Maliq	702,250	623,930	78,320	89%	9,100	0	9,100	0%
2	Gjirokastrë	1,716,879	745,696	971,183	43%	1,520	0	1,520	0%
3	Devoll	986,527	986,527	0	100%	6,000	0	6,000	0%
4	Dibër	1,445,600	995,600	450,000	69%	12,000	0	12,000	0%
5	Cërrik	763,033	650,122	112,911	85%	8,000	0	8,000	0%
6	Belsh	952,340	949,325	3,015	100%	1,000	0	1,000	0%
7	Kurbin	1,067,365	157,330	910,035	15%	5,250	0	5,250	0%
8	Kukës	1,251,000	403,000	848,000	32%	2,500	0	2,500	0%
9	Librazhd	717,600	709,670	7,930	99%	8,500	0	8,500	0%
10	Divjakë	701,000	683,000	18,000	97%	0	0	0	0%
11	Mat	1,024,000	732,000	292,000	71%	10,000	0	10,000	0%
12	Himarë	469,500	429,500	40,000	91%	57,000	0	57,000	0%
13	Krujë	828,260	555,460	272,800	67%	12,320	0	12,320	0%
14	Mallakastër	660,310	359,210	301,100	54%	33,100	0	33,100	0%
15	Patos	1,071,449	468,313	603,136	44%	15,000	0	15,000	0%
16	Malesi_e_Madhe	618,000	374,000	244,000	61%	3,500	0	3,500	0%
17	Gramsh	746,000	619,100	126,900	83%	3,150	0	3,150	0%
18	Rrogozhinë	499,000	458,000	41,000	92%	21,900	0	21,900	0%
19	Bulqizë	1,050,657	309,000	741,657	29%	3,065	0	3,065	0%
20	Përmet	495,173	469,260	25,913	95%	1,500	0	1,500	0%
21	Dropull	915,860	88,000	827,860	10%	1,100	0	1,100	0%
22	Vorë	608,000	378,000	230,000	62%	20,000	0	20,000	0%
23	Kolonje	285,866	184,866	101,000	65%	900	0	900	0%
24	Ura Vajgurore	519,201	483,444	35,757	93%	0	0	0	0%
25	Selenicë	448,000	98,000	350,000	22%	0	0	0	0%
26	Peqin	584,000	571,000	13,000	98%	0	0	0	0%
27	Skrapar	339,000	137,000	202,000	40%	35,000	0	35,000	0%
28	Tropojë	339,500	278,500	61,000	82%	3,000	0	3,000	0%
29	Vau Dejës	515,400	446,200	69,200	87%	9,000	0	9,000	0%
30	Delvinë	264,348	172,508	91,840	65%	3,735	0	3,735	0%
31	Roskovec	326,845	283,164	43,681	87%	2,122	0	2,122	0%
32	Mirditë	397,554	265,335	132,219	67%	5,446	0	5,446	0%
33	Poliçan	250,000	188,000	62,000	75%	0	0	0	0%
<b>Totali</b>		<b>23,559,517</b>	<b>15,252,060</b>	<b>8,307,457</b>	<b>65%</b>	<b>294,708</b>	<b>0</b>	<b>294,708</b>	<b>0%</b>
<b>Konsumi i Autorizuar në Total 23,854,225 m3</b>									

### Grupi i III-të

Në Grupin e III-të të shoqërive, **Konsumi i Autorizuar Total** është **2,536,045 m<sup>3</sup>** ujë. Niveli i matjes për ujin e faturuar në rang grupi rezulton 64%. Krahasuar me një vit më parë, niveli i matjes është përmirësuar me 11% pasi shoqëritë UK Finiq, Klos dhe Këlcyrë kanë rritur numrin e lidhjeve me matës. Me nivelin më të lartë të matjes paraqitet UK Pustec (100%).

Konsumi i Autorizuar që nuk faturohet, pasi përdoret nga shoqëritë për nevojat e tyre etj, është në nivelin 0.9% e konsumit total të autorizuar .

Konsumi i Autorizuar i Matur dhe i Pamatur Grupi i III-të, në mënyrë të detajuar jepet në Tabela 8.

**Tabela 8 Konsumin i Autorizuar, i Matur dhe i Pamatur Grupi i III-të**

Nr.	Operatorët UK	Konsumi i Autorizuar i Faturuar			Uji i Faturuar me Matje në %	Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar			Uji i Pa Faturuar me matje në %
		Total (m3)	I matur (m <sup>3</sup> )	Aforfe (m3)		Totali (m <sup>3</sup> )	I matur (m <sup>3</sup> )	I vlerësuar (m <sup>3</sup> )	Uji i Pa Faturuar me matje në % (%)
1	Tepelenë	310,000	235,000	75,000	76%	7,000	0	7,000	0%
2	FinIQ	234,600	119,100	115,500	51%	1,480	0	1,480	0%
3	Konispol	301,432	293,642	7,790	97%	200	0	200	0%
4	Memaliaj	164,420	136,050	28,370	83%	0	0	0	0%
5	Klos	278,550	128,550	150,000	46%	3,000	0	3,000	0%
6	Pukë	181,505	151,085	30,420	83%	1,000	0	1000	0%
7	Këlcyrë	203,600	174,200	29,400	86%	350	0	350	0%
8	Has	358,040	250,515	107,525	70%	7,500	0	7500	0%
9	Libohovë	324,104	9,110	314,994	3%	1,000	0	1000	0%
10	Fushë Arrëz	101,764	56,500	45,264	56%	500	0	500	0%
11	Pustec	56,000	56,000	0	100%	0	0	0	0%
<b>Totali</b>		<b>2,514,015</b>	<b>1,609,752</b>	<b>904,263</b>	<b>64%</b>	<b>22,030</b>	<b>0</b>	<b>22,030</b>	<b>0%</b>
<b>Konsumi i Autorizuar në Total 2,536,045 m3</b>									

Konsumi i Autorizuar Total, i Faturuar dhe i pa Faturuar për sektorin UK, paraqitet në tabelën 9.

**Tabela 9 Konsumi i Autorizuar i Matur dhe i Pamatur për Sektorin**

Grupet	Konsumi i Autorizuar i Faturuar			Uji i Faturuar me Matje	Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar			Uji i Pa faturuar me Matje
	Totali sipas grupeve (m3)	I matur (m3)	aforfe (m <sup>3</sup> )	(%)	Total (m3)	I matur (m3)	I vlerësuar (m <sup>3</sup> )	(%)
Grupi I-rë	84,628,231	66,805,113	17,823,118	79%	767,316	620	766,696	0%
Grupi II-të	23,559,517	15,252,060	8,307,457	65%	293,208	0	293,208	0%
Grupi III-të	2,514,015	1,609,752	904,263	64%	22,030	0	22,030	0%
<b>Total</b>	<b>110,701,763</b>	<b>83,666,925</b>	<b>27,034,838</b>	<b>76%</b>	<b>1,082,554</b>	<b>620</b>	<b>1,081,934</b>	<b>0%</b>
<b>Konsumi i Autorizuar në Total 111,785,817 m<sup>3</sup></b>								

**Sa më sipër konstatohet:**

- **Konsumi i Autorizuar Total i 58<sup>të</sup> shoqërive UK është 111,785,817 m<sup>3</sup>ujë, Konsumi i Autorizuar i Faturuar rezulton 99% i Konsumit të Autorizuar Total dhe matet në nivelin 76%. Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar me trend në përmirësim, rezultoi 1% i Konsumit të Autorizuar Total.**
- **Niveli i matjes për ujin e faturuar rezulton i përmirësuar me 1%, planifikimi i nevojave për investime në ujëmatësa vërehet pothuajse në të gjitha shoqëritë UK. E drejta për të paguar sipas konsumit real e të matur, nuk mund t'i privohet asnjë konsumatori.**

### **1.3 Uji Pa të Ardhura, Humbjet e Dukshme dhe Humbjet Reale**

#### **Të Përgjithshme mbi Humbjet**

**Ujë Pa të Ardhura (UPA)** konsiderohet vëllimi i ujit i prodhuar që nuk arrin t'ju faturohet klientëve, pra që nuk gjeneron të ardhura për shoqërinë e ujësjellësit. UPA përfaqëson diferencën mes vëllimit në hyrje (input) të sistemit dhe Konsumit të Autorizuar të Faturuar.

**Vlerësimi i komponentëve të UPA-s është pjesa më e rëndësishme e Bilancit të Ujit, niveli i humbjeve për çdo komponent përbërës është përcaktues në hartimin e planeve të veprimit për reduktimin e UPA.**

**Humbjet e Ujit** ose Humbjet e Përgjithshme përbëjnë diferencën ndërmjet vëllimit në hyrje të sistemit dhe Konsumit të Autorizuar (të faturuar dhe të pa faturuar) dhe përbëhet nga Humbjet e Dukshme dhe Humbjet Reale.

**Humbjet e Dukshme** ose Administrative shkaktohen nga konsumi i pa autorizuar, pasaktësi të matjes në prodhim dhe tek konsumatori, si dhe gabimet sistematike në trajtimin e të dhënave.

**Humbjet e dukshme nuk duhet të nënvlerësohen, ato nuk gjenerojnë të ardhura për ujin që është prodhuar, trajtuar, transportuar apo dërguar te konsumatori.**

Në humbjet e dukshme, rëndësi e veçantë duhet ti kushtohet **Konsumit të Pa Autorizuar** i cili shkaktohet nga lidhjet ilegale, nën faturimet, matësit e keqtrajtuar apo manipuluar nga klientët, nxjerrja e paligjshme e ujit nga hidrantët e zjarrit si edhe mitëdhënia dhe korruptimi i lexuesve apo i punonjësve të tjerë të shoqërisë.

**Për lidhjet ilegale**, treguesi bazë për ekzistencën e një numri të konsiderueshëm të tyre, është diferenca e evidente në data bazë ndërmjet numrit të popullsisë së shërbyer me numrin e kontratave që ka shoqëria me konsumatorët familjarë. Në këtë diferencë peshë të madhe mund të kenë edhe lidhjet dyfishe, prania e të cilave mund të evidentohet nga nivelet mjaft të ulëta të faturimeve për konsumatorët familjarë me matje. **Evidentimi në terren dhe planifikimi i investimeve për tubacionet e amortizuara, ne zonat ku dyshohet që ka prani të madhe të lidhjeve të paligjshme, do të zbulojnë dhe eliminojnë humbjet e shkaktuara prej tyre.**

**Nën faturimi**, shkaktohet nga korruptimi i faturuesve të cilët nuk faturojnë sasinë reale të matur të ujit në konsumatorët me matje, si edhe prania e lidhjeve dyfishe ose by-pass i matësit. **Ky fakt konstatohet kur vërehet normë mesatare konsumi në konsumatorët me matje nën vlerat historike apo mesatare të pritshme në ujësjellës të ngjashëm.** Si normë mesatare vjetore konsumi mund të përdoret norma prej 80 litra/ditë, banor, bazuar kjo në eksperiencën e disa prej shoqërive me nivel 100% të matjes për kategorinë e konsumatorëve, si Korça dhe Pogradeci.

Për eliminimin e këtij fenomeni, zgjidhja më e mirë është pajisja me matësa inteligjent e konsumatorëve, investim ky me kosto të lartë që kërkon mbështetjen donatorëve apo të Qeverisë Vendore.

Nën faturimet mund të ndodhin edhe tek konsumatorët familjare me faturim aforfe, për këtë shoqëritë duhet t'u kërkojnë klientëve të cilët faturohen aforfe të paraqesin një certifikatë të gjendjes familjare që vërteton numrin e saktë të tyre.

**Humbjet Reale** ose Fizike të ujit në sistemin e furnizimit me ujë, përfshijnë të gjitha tipet e rrjedhjeve në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, rrjedhjet e depove, rrjedhjet për shkak të riparimeve në sistem, në stacionin e pompave dhe në burimet e ujit.

Metoda e përdorur për hartimin e Bilancit të Ujit "lart-poshtë", presupozon që humbjet reale llogariten në fund si diferencë e ujit që hyn në sistem me shumën e të gjithë komponentëve të tjerë të bilancit, pra ujit të faturuar, konsumit të autorizuar të pa faturuar dhe humbjeve të dukshme (administrative).

Llogaritja e elementëve të humbjeve fizike është e mundur nëse rrjetet shpërndarëse janë të ndara në zona të veçanta të pavarura (DMA) dhe me matje individuale 100% të konsumatorëve. I vetmi komponent i mundshëm i humbjeve fizike që mund të llogaritet (matet) janë rrjedhjet në depo, por që së bashku me kapërderdhjet e mundshme ky komponent nuk duhet të kalojë vlerën 3% të sasisë së ujit që hyn në sistem.

**Konceptimi dhe ndërtimi i rrjeteve shpërndarëse sipas DMA-ve është domosdoshmëri për vlerësimin dhe reduktimin e humbjeve për të realizuar dhe arritur më tej në regjimin e furnizimit me ujë 24/7 orë në ditë.**

## Grupi i I-rë

Për vitin 2021, niveli i UPA ne Grupin e I-rë të shoqërive rezultoi **66.8%**. Shoqëritë prodhuan **255,254,680 m<sup>3</sup>** ujë ndërsa faturimi total arriti në nivelin **84,628,231m<sup>3</sup>**. Krahasuar me një vit më parë, **treguesi UPA i përmirësuar me (-1.3%) ende është në nivele të papranueshme.** Reduktimi i UPA nga të gjitha shoqëritë e grupit të parë do të bëjë të mundur dhe përmirësimin e nivelit të humbjeve në sektorin UK pasi ato administrojnë rreth 77% të lidhjeve me ujin.

Përmirësim i treguesit UPA vërehet në disa prej shoqërive të grupit por përsëri niveli humbjeve është i papranueshëm për shoqëritë UK Durrës (79.2%), UK Vlorë ( 76.2%), UK Elbasan ( 74.5%), UK Fier (74.5%), UK Shkodër (69.2%), UK Kamëz (70.7%), UK Berat-Kuçovë (65.9%) etj.

Me nivelin më të ulët të treguesit UPA u paraqiten UK Korçë me 34.7%, UK Lezhë me 37.6% dhe UK Pogradec me 38,7%.

**Uji Pa të Ardhura në grup është 170,626,449 m<sup>3</sup> ose 3 milion m<sup>3</sup> më pak se vitin e kaluar. Humbjet e Dukshme,** të reduktuara për këtë vit me rreth 2.1 milion m<sup>3</sup>, rezultojnë në nivelin **83,187,115 m<sup>3</sup> ose 48.8% të UPA.** Humbjet e shkaktuara nga prezenca e lidhjeve të paligjshme në transmetim (25,867,762 m<sup>3</sup>) dhe shpërndarje (28,388,571 m<sup>3</sup>) rezultojnë të jenë 67% e humbjeve të dukshme, *Niveli i lartë i humbjeve nga lidhjet e paligjshme kërkon angazhim për menaxhimin më të mirë nga të gjitha shoqëritë UK, sidomos në zonat rurale.*

Fenomeni i nën faturimit si pasojë e korrupsionit të faturuesve ende është prezent në shoqëritë UK. Klientë familjar, sidomos në zonat rurale konsumojnë sasi të mëdha uji për nevoja vetjake dhe për vaditje, ndërkohë që faturimi i kryer nuk përkon me konsumin real. Gjithashtu një numër i konsiderueshëm klientësh biznesi si hoteleri, restorante etj, shpesh herë faturohen si klientë familjar. Klientët familjare që faturohen aforfe duhet të jenë nën kontrollin e shoqërive UK për sa i përket numrit të banoreve, për të cilët është lidhur një kontratë shërbimi. Ata duhet të dorëzojnë pranë shoqërisë certifikatën familjare në të cilën paraqitet numri i banorëve aktual, i cili shërben si bazë për faturimin aforfe(150 litra/dite, banor).

**Me nivele të larta të humbjeve të dukshme u paraqiten shoqëritë UK Fier 187.3 l/d, banor, UK Durrës 138.7 l/d, banor, UK Elbasan 133.6 l/d, banor, UK Vlorë 123.6 l/d, banor etj.**

**Humbjet Reale,** të cilat shkaktohen nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, gjatë këtij viti paraqitën tendencë në përkeqësim(+0.1%). Në raport me nivelin e UPA-së në grup, ato përbëjnë 50.8% e tyre ose **86,672,018 m<sup>3</sup>.** Bazuar në raportet mbi “Bilancin e Ujit” për gjatë 9 viteve, konstatohet se niveli i humbjeve reale dhe administrative në raport me UPA, nuk pasqyrojnë nivelin real që ato kanë si pasojë e përlllogaritjes jo të saktë të nën komponentëve përbërës të secilit.

**Humbjet Reale, në litra/ditë, banor, paraqiten në nivele mjaft të larta për UK Durrës 140.4 l/d, banor, UK Vlorë 136.3 l/d, banor, UK Fier 120.3 l/d, banor, UK Kavajë 101.9 l/d, banor etj.**

*Nëse regjimi i furnizimit me ujë do të ishte i pandërprerë, vlera absolute e humbjeve të shprehura në litra/ditë për banor do të ishte akoma më e madhe.*

**Sa më sipër, për vitin 2021 shoqëritë e Grupit të I-rë, kanë prodhuar 283.7 l/ditë, banor, kanë faturuar 94.1 l/ditë, banor dhe humbasin 189.6 l/ditë, banor.**

**Tabela 10** jep një pasqyrë të plotë të Humbjeve të Dukshme dhe ato Reale për shoqëritë e grupit të parë.

Për të bërë faktike problemet lidhur me nën faturimet apo faturimet nën vlerën e parashikuar me VKM, është hartuar tabela mbi **Konsumin Mesatar të Autorizuar i Matur dhe Aforfe.**

Në **Tabelën 11** paraqiten të dhënat e Grupit të I-rë mbi Konsumin Mesatar të Autorizuar me matje dhe aforfe të shprehura në litra/ditë, banor. Probleme me nën faturimin për klientët familjare me matje vërehet në shoqëritë UK Korçë, UK Lezhë, UK Kamëz dhe UK Berat-Kuçovë. Për shoqëritë UK Korçë dhe Lezhë, ky fenomen ka ndodhur jo vetëm si pasojë e zgjerimit të zonës së juridiksionit me zonat rurale, ku prezenca e lidhjeve të dyfishta dhe abuzimet me ujëmatësit mund të jenë më të mëdha në numër, por edhe si rezultat i



një numri mjaft të madh të shtëpive të dyta të klientëve të cilët nuk banojnë në mënyrë të përhershme në këto qytete.

Gjatë analizës u konstatua se UK Korçë, në raportimin mbi lidhjet e ujit ka edhe lidhje pa matës ndërkohë që nuk raporton konsum të autorizuar aforfe. UK Korçë duhet të bëjë verifikimet mbi lidhjet e ujit, kryesisht për ato në zonat rurale, për të kryer faturimin e duhur në të ardhmen(i matur apo aforfe).

**Konsumi i Autorizuar Mesatar aforfe** i shprehur në litra/ditë, banor tregon për faturim nën vlerën e parashikuar me VKM për faturimin aforfe apo nga ndonjë anomali të mundshme të gabimit sistematik të sistemit që duhet korrigjuar. Probleme me faturimin aforfe që duhet verifikuar paraqesin shoqëritë UK Tirane, UK Kamëz, UK Lezhë, UK Sarandë, UK Elbasan etj.

**Tabela 10 UPA, Humbjet e Dukshme, Reale dhe nga Konsumi i Pa autorizuar- Grupi i I-rë**

Nr.	Operatorët	Uji Pa të Ardhura (UPA)			Humbjet e Dukshme (Administrative)			Humbjet Reale (Fizike)			Humbjet nga Konsumi i Autorizuar i Pafaturuar		
		(m <sup>3</sup> )	(%)	(litra/ditë , banor)	(m <sup>3</sup> )	(%)	(litra/ditë, banor)	(m <sup>3</sup> )	(%)	(litra/ditë , banor)	(m <sup>3</sup> )	(%)	(litra/ditë , banor)
1	Tiranë	54,549,303	58.7%	180.8	25,107,459	46.0%	83.2	29,423,947	53.9%	97.5	17,897	0.03%	0.1
2	Durrës	35,171,835	79.2%	279.1	17,475,314	49.7%	138.7	17,696,521	50.3%	140.4	-	0.00%	0.0
3	Vlore	17,453,717	76.2%	260.7	8,274,888	47.4%	123.6	9,124,829	52.3%	136.3	54,000	0.31%	0.8
4	Elbasan	13,031,370	74.5%	229.7	7,579,268	58.2%	133.6	5,276,562	40.5%	93.0	175,540	1.35%	3.1
5	Fier	14,020,000	75.1%	308.3	8,518,460	60.8%	187.3	5,471,540	39.0%	120.3	30,000	0.21%	0.7
6	Shkodër	8,823,417	69.2%	204.8	5,148,216	58.3%	119.5	3,568,288	40.4%	82.8	106,913	1.21%	2.5
7	Korçë	1,217,638	34.7%	27.8	436,843	35.9%	10.0	780,265	64.1%	17.8	530	0.04%	0.0
8	Berat Kuçovë	5,477,297	65.9%	137.0	1,857,936	33.9%	46.5	3,544,535	64.7%	88.7	74,826	1.37%	1.9
9	Kavajë	5,630,890	66.6%	187.1	2,508,400	44.5%	83.4	3,066,490	54.5%	101.9	56,000	0.99%	1.9
10	Kamëz	7,036,418	70.7%	190.8	3,355,434	47.7%	91.0	3,584,044	50.9%	97.2	96,940	1.38%	2.6
11	Lushnje	4,007,672	67.0%	117.4	2,007,417	50.1%	58.8	1,965,255	49.0%	57.6	35,000	0.87%	1.0
12	Sarandë	2,077,673	48.3%	97.5	574,899	27.7%	27.0	1,409,764	67.9%	66.1	93,010	4.48%	4.4
13	Pogradec	952,959	38.7%	33.2	290,350	30.5%	10.1	640,409	67.2%	22.3	22,200	2.33%	0.8
14	Lezhë	1,176,260	37.6%	47.4	52,231	4.4%	2.1	1,119,569	95.2%	45.1	4,460	0.38%	0.2
<b>Total</b>		<b>170,626,449</b>	<b>66.8%</b>	<b>189.67</b>	<b>83,187,115</b>	<b>48.8%</b>	<b>92.47</b>	<b>86,672,018</b>	<b>50.8%</b>	<b>96.35</b>	<b>767,316</b>	<b>0.45%</b>	<b>0.85</b>

